



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA

PRANË GJYKATËS SË APELIT ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM
VLORË

Nr 293 prot.

Dt.28.02.2022

Lenda : Dergohet Raporti Vjetor i veprimtarise punes per vitin 2021.

Drejtuar : PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM
Z. Olsian ÇELA

TIRANË

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm,

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr. 172 prot., datë 08.02.2022, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.179 prot., datë 09.02.2022, ju informojmë se:

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni të përmbledhur Raportin Vjetor për ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit Vlorë për vitin 2021.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I PROKURORISË



R A P O R T

MBI VEPRIMTARINË E PROKURORISË SË APELIT VLORË PËR VITIN 2021

Objekti: Raportimi mbi treguesit kryesorë të punës dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore të Prokurorisë së Apelit Vlorë, për vitin 2021.

I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm,

Prokuroria e Apelit Vlorë, në përmbushje të nenit 50 i ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë", i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm, Raportin Vjetor mbi ecurinë e punës në këtë prokurori për vitin 2021.

Raporti do të informojë në mënyrë të detajuar zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, Udhëzimit nr. 4, datë 09.07.2021 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", Urdhrit nr.79, datë 09.07.2021 "Për miratimin e planveprimit për zbatimin e e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit" Urdhër nr 78, datë 09.07.2021 "Për miratimin e planveprimit për zbatimin e rezolutës".

Gjatë vitit 2021 Prokurorët në Prokurorinë e Apelit Vlorë, kanë ushtruar funksionet e tyre në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve procedurale dhe ligjeve materiale në fuqi, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, me qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe të Drejtat e Njeriut. Prokurorët janë ndihmuar në punën e tyre nga punonjësit e administratës së Prokurorisë së Apelit Vlorë, në respektim të Kodit të Etikës, si dhe në zbatim të Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, duke treguar më shumë profesionalizëm dhe efikasitet në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 96/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë ka hartuar materialin analitik mbi treguesit kryesorë të punës së kryer gjatë vitit 2021, në përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlore, si dhe në zbatimin e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore.

Në vitin 2021, struktura e Prokurorisë së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Vlorë, ka patur në organikën e vet 5 prokurorë, nga të cilët koleget Enrik Haxhiraj dhe Pelivan Malaj janë shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit qysh në muajin Janar 2021, ndërkohe që, në muajin Shtator 2021, u shkarkuar po me vendim të KPK-se edhe z. Erion Çela, i cili deri në atë periudhë ushtronte funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit.

Në organikën aktuale të Prokurorisë së Apelit Vlorë, që prej datës 23.09.2021 ushtrojnë funksionin e prokurorit në këto Zyre dy prokurorë, z.Kleanth Zeka që njëkohësisht është edhe i komanduar përkoheishtë të ushtrojë funksionin e Drejtuesit, si dhe prokurorja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, znj.Elida Hoxhaj, e komanduar përkoheishtë në këto detyra me vendim të KPK-se, për shkak të vakancave të theksuara të krijuara si pasoje e zbatimit të ligjit nr. 84/2016 "*Për rivlersim të kalimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*".

PËRFAQËSIMI I AKUZËS NË GJYKIM DHE PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE TË TJERA LIGJORE.

Gjatë vitit 2021, nga i gjithë personeli i Prokurorisë së Apelit Vlorë është treguar kujdesi i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve ligjore në përfaqësimin e akuzës gjatë gjyqimit në apel edhe pse gjatë vitit janë krijuar vende vakante për shkak të pezullimit nga detyra të dy prokurorëve në zbatim të ligjit nr. 84/2016 "*Për rivlersim të kalimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*". Edhe pse me mungesë të theksuar në strukturë, jemi përpjekur për zbatimin e detyrimeve ligjore, sikurse do të analizohen më hollësisht në vijim.

1.1.Lidhur me **përfaqësimin e akuzës** gjatë gjyqimit në apel dhe **respektimin e afateve** ligjore, gjatë vitit 2021, nga Prokuroria e Apelit Vlorë janë respektuar me korrektësi detyrimet e ligjit procedural penal, si dhe urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, për respektimin e afateve në shqyrtimin e çështjeve të ankimuar.

Është siguruar prezenca e prokurorëve në të gjitha seancat gjyqësore në Gjykatën e Apelit, si për çështjet e themelit, për masat e sigurimit apo ankimet e vecanta, duke respektuar solemnitetin dhe etikën në gjykim, si dhe respektimin e afateve për lëshimin në kohë të urdhërave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Apelit, dërgimin e vendimeve penale në prokuroritë e rrethëve gjyqësore kompetente, ushtrimin brenda afateve ligjore të së drejtës së rekursit në Gjykatën e Lartë, si dhe njoftimin e këtij akti edhe Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka patur raste të moszhvillimit të seancave gjyqësore, për shkak të mungesës për arsye joobjektive të prokurorëve, apo vonesa të tjera.

Gjithashtu nuk ka patur asnjë rast gjatë vitit 2021, që ndaj prokurorëve, apo punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Apelit Vlorë, të jenë inicuar procedime disiplinore, apo të jenë marrë masa disiplinore nga organet kompetente sipas ligjit, për shkaqet e përmendura më sipër.

1.2.Gjatë kësaj periudhe kohore, ka qenë në vëmendjen e prokurorëve respektimi i parashikimeve të **rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë** dhe planit të veprimit në zbatim të saj, zbatimi i **rekomandimeve të Këshillit të Ministrave**, si dhe **udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm** për luftën kundër kriminalitetit, në drejtim të kërkimeve penale në gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Vlorë, në fokus të atyre rekomandimeve dhe udhëzimeve.

1.3 Përmbajtja e atyre akteve, përveçse është shpërndarë tek cdo prokuroror, është diskutuar dhe punuar me prokuroret e kësaj zyre.

1.4. Në zbatim të detyrimeve të ligjit penal dhe rekomandimeve të akteve të lartpërmendura, për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si për veprat penale kundër jetës së personit, veprat penale në fushën e trafikimit, prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, veprat penale që lidhen me të miturit dhe krimet seksuale me të mitur dhe dhunën në familje, si edhe veprat penale kundër pasurisë, ato që lidhen me krimin ekonomik apo abuzimin me detyrën nga zyrtarët shtetërore, etj, kërkimet e prokurorëve të apelit për masat e sigurimit dhe gjykimet e themelit, kanë qenë në mbështetje të provueshmërisë së akuzave dhe për sanksione dënimi në raport me rrezikshmërinë e veprave penale.

1.5. Ndërkohë që në rastet e parashikuara nga ligji dhe kur vendimet e Gjykatës së Apelit kanë qenë të ndryshme nga kërkimet e akuzës, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë për çështjet respektive.

1.6. Lidhur me **bashkëpunimin me institucionet e tjera**, gjatë vitit 2021 kanë vijuar raportet korrekte me institucione të tjera, në zbatim të ligjit procedural dhe atij organik për Prokurorinë. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

- Gjykatën e Apelit Vlorë, për fazën, që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykimin e çështjeve të ankimuar, si dhe të detyrimeve të përbashkëta administrative për mbarëvajtjen e punës.
- Prokuroritë e rretheve gjyqësore, që veprojnë në juridiksionin e Apelit Vlore, për bashkëveprimin në funksion të përfaqësimit sa më të mirë të akuzës në çështjet e ankimuar, veprimtarisë në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe detyrimeve të tjera ligjore të prokurorit.
- Strukturat e Policisë së Shtetit dhe institucionet e tjera që përfshijnë shërbime të policisë gjyqësore, për bashkëpunimin në gjykimin e çështjeve të ankimuar dhe zbatimin e urdhërave për ekzekutimin e vendimeve penale.
- Me Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për fazën e ekzekutimit.
- Me Prokurorinë e Përgjithshme, si institucioni që përfaqëson çështjet e rekursuara, si dhe në bashkëpunimin për çështje të tjera të natyrës administrative.
- Me institucionet e tjera, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore.

1.7. BASHKËPUNIMI ME GJYKATËN E APELIT VLORË

Sikurse u përmend edhe me sipër, raportet e kësaj zyre me Gjykatën e Apelit Vlorë, kanë qenë korrekte dhe ligjore, në përfaqësimin e akuzës në gjykimet në apel dhe plotësimin e detyrimeve të tjera ligjore. Nga ana e prokurorëve, nisur edhe nga fakti që dy institucionet ndodhen në të njëjtën godinë, është respektuar me korrektësi pjesëmarrja e tyre në kohë në gjykim, ndërkohë që nga ana tjetër edhe nga kolegjet gjyqësore është konstatuar angazhim i plotë për mbarëvajtjen e gjykimeve, respektimin e solemnitetit të tij, ruajtjen e sekretit për vendimet, që lidhen me akte të asaj natyre të hetimeve paraprake, procedurat për dërgimin në organet kompetente të vendimeve penale me ekzekutim të menjëhershëm etj.

Është fakt se, sic u theksua, krijimi i vakancave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka shkaktuar edhe problematikat e veta në funksionimin e punës në këtë gjykatë, pasi nga ana e prokurorëve në detyrë ka qenë e pamundur të ndiqet ritmi i lartë i punës për arsye objektive. Për pasojë, në më tepër se një rast, nga ana jonë janë zhvilluar takime dhe mbledhje të përbashkëta me Gjykatën e Apelit Vlorë, me qëllim reduktimin sadopak të numrit të çështjeve të planifikuara për gjykim, duke ju dhënë përparësi atyre me të pandehur të arrestuar, çështjeve që i përkisnin kërkesave të prokurorëve dhe palëve në fazën e hetimeve paraprake dhe ato të seancës paraprake dhe natyrisht edhe atyre çështjeve me objekt ankimin ndaj masave të sigurimit. Duhet pranuar se, në përgjithësi, nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë kemi gjetur mirëkuptim dhe mbështetje dhe në fund mendoj se, me ndonjë problematikë të vogël, ja kemi dalë të përballojmë ngarkesën në punë, duke garantuar përmbushjen e detyrimit për dhënien e drejtësisë penale në këtë gjykatë.

Po ashtu një vëmendje e posacme i është kushtuar përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta ligjore në fushën e administrimit të drejtësisë, sikurse përpjekjet e përbashkëta për rritjen e nivelit të sigurisë në godinë, transparencën ndaj publikut nëpërmjet afishimit paraprakisht të listave të gjykimeve penale në apel etj.

1.8. BASHKËPUNIMI ME PROKURORITË E RRETHEVE GJYQËSORE TË JURIDIKSIONIT TË APELIT VLORË

Edhe gjatë vitit 2021 kanë vijuar raportet e bashkëpunimit me të gjitha Prokuroritë e Rretheve të Juridiksionit të Apelit, për trajtimin e problematikave që hasen në gjykimin e çështjeve të ankimuar, si për qëllime të rritjes së nivelit cilësor të apeliave, shkëmbimit të informacioneve për fazën e çështjeve konkrete, trajtimin juridiko-penal të kazuseve të diskutueshme, dërgimit të njoftimeve për fazën e ekzekutimit të vendimeve penale etj.

Në funksion të sa më sipër dëshirojmë të theksojmë praktikën e Prokurorisë së Apelit Vlorë që për problematikat e përgjithshme të hasura gjatë gjykimeve në apel, pavarësisht se ato mund të ndeshen në çështje konkrete të rretheve gjyqësore të caktuar, nga kjo zyrë dërgohen materiale përgjithësuese për të gjitha zyrat e prokurorive në juridiksionin apeli, në mënyrë që ato problematika të diskutohen me të gjithë prokurorët.

Ndër rastet e tilla të materialeve me problematika të përgjithshme mund të përmendim ato që tërheqin vëmendjen për respektimin rigoroz të kërkesave të ligjit procedural për formën dhe shkaqet e apeliave të prokurorit, ato për domosdoshmërinë e kërimit tekstual të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apeli kundër vendimeve të shkallës së parë të gjykimit, që deklarohen pafajësinë për shkak të mungesës së provave ndaj të pandehurit, ato që kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve penale me ekzekutim të menjëhershëm etj.

Përmirësimi të punës në këtë drejtim, i shërben edhe praktika e Prokurorisë së Apelit Vlorë, për përpilimin dhe mbajtjen e evidencave mujore të përfaqësimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Vlorë, sipas rretheve përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe kemi gjetur mirëkuptimin e plotë të drejtuesve dhe prokurorëve të zyrave përkatëse për përmirësimin e problematikave të hasura, si rritjen e nivelit cilësor të apeliave, parashtrimin të të gjitha shkaqeve ligjorë në to, ushtrimin e apeliave për masat e sigurimit vetëm për

rastet e domosdoshme të hetimit paraprak, përmirësimin e komunikimit dhe njoftimit të zyrave respektive për rrethanat e gjyqimit, në shkallën e parë dhe në apel etj.

1.9. BASHKËPUNIMI ME STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT.

Raportet me strukturat e policisë së shtetit në drejtoritë vendore të policisë së qarqeve e Vlorë, Fier dhe Berat, gjatë vitit 2021 kanë qenë tërësisht korrekte dhe ato përfshijnë kryesisht njoftimet e palëve në fazën e gjyqimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale nga prokurorët e apelit, apo në bashkërendimin e veprimeve në funksion të administrimit të drejtësisë.

1.10. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE.

Raportet me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale Vlorë, Fier, Lushnje dhe Berat, gjatë vitit 2021, kanë qenë intensive, bashkëpunuese dhe korrekte dhe ato janë shtrirë në të gjitha aspektet ku ligji e parashikon këtë bashkëpunim, përfshirë atë të njoftimeve, shkëmbimit të informacioneve të nevojshme për çështjet, në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në kompetencë të prokurorëve të apelit, sikurse janë ato për masat e sigurimit apo urdhërimet e tjera të gjykatës etj.

1.11. BASHKËPUNIMI ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME.

Gjatë vitit 2021 ka vijuar raporti i ngushtë i bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky bashkëpunim është shtrirë jo vetëm me Prokurorin e Përgjithshëm dhe Drejtorinë Gjyqësore, për dërgimin e rekurseve dhe informimin nga prokurorët pranë Gjykatës së Lartë për mënyrën e përfundimit të tyre, apo Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë për shkëmbimin e të dhënave në atë fushë, por edhe me të gjitha drejtoritë dhe sektorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme.

Në sajë të këtij bashkëpunimi dhe plotësimit të nevojave administrative nga sektorët e tjerë të Prokurorisë së Përgjithshme, është bërë e mundur përballimi i një volumi të konsiderueshëm pune nga Prokuroria e Apelit Vlorë.

Gjatë vitit 2021 (pas ndryshimeve ligjore) ka vijuar praktika e mirë e viteve të mëparshme që rekurset e prokurorëve të apelit, si për masat e sigurimit edhe për vendimet përfundimtare, krahas depozitimit në gjykatë, dërgohen paralelisht për njoftim edhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Edhe gjatë vitit 2021 janë respektuar detyrimet e prokurorëve për të zbatuar në kohë dhe me cilësi urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ushtrimin e funksioneve të prokurorit në apel.

1.12. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA.

Gjatë vitit 2021 është përmbushur në mënyrë korrekte përfaqësimi i Prokurorisë së Apelit në raport me institucionet e tjera, të nivelit qëndror apo vendor, në zbatim të detyrimeve të ligjit organik për prokurorinë.

2. ANALIZA E TREGUESVE TË VOLUMIT TË PUNËS.

Treguesit e volumit të përgjithshëm të punës, të kryer nga prokurorët për vitin 2021, përfshijnë të dhënat për sa më poshtë vijon :

- Çështjet e reja të filluara dhe të përfunduara gjatë vitit 2021,
- Çështjet e mbartura nga viti 2020 dhe të përfunduara gjatë vitit 2021,
- Çështjet për veprën penale të dhunës në familje.
- Çështjet për vepra penale të kryera nga të miturit në konflikt me ligjin.
- Çështje të paperfunduar gjatë vitit 2021 dhe të mbartura për vitin 2022.

2.1 Në **total** gjatë vitit 2021, nga prokurorët e apelit është përfaqësuar akuza në çështjet në gjykim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për 1502 **çështje** nga të cilat:

- **374** çështje themeli **gjithsej**, prej të cilave **57** çështje janë për veprën penale të dhunës **në familje**, **16** çështje janë me të pandehur **të mitur** dhe **14** çështje janë **kundravajtje penale**.
- **534** çështje (me **676** persona) të masave të sigurimit,
- **594** çështje mbi ankime të veganta, si ankime kundër vendimeve të pushimit apo mosfillimit, të fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, me të dëmtuar akuzes etj.
- **67** çështje janë **mbartur** në gjykim për vitin 2022, përfshirë çështje themeli dhe të vecanta, nga të cilat 29 çështje prokurori Kleanth Zeka dhe 38 prokurore Elida Hoxhaj, por pjesa me e madhe e të cilave janë përfunduar në momentin e këtij raportimi.

2.2. Nga këndvështrimi **krahasimor** me volumin e punës të përballuar në vitin **2021**, këto të dhëna rezultojnë disi më të ulëta vetëm në shqyrtimin e çështjeve të themelit në Gjykatën e Apelit Vlorë, ndërkohë që rezultojnë në një numër më të lartë çështjet lidhur me masat e sigurimit, si dhe një nivel më i lartë në shqyrtimin e ankimeve për çështje të veganta.

2.3. Nisur nga volumi i natyrës së çështjeve, faktori kryesor që ndikon në numrin e lartë të çështjeve të vecanta gjatë vitit 2021, është ai që lidhet me shqyrtimin e ankimeve të vendimeve gjyqësore të seancës paraprake, pas ndryshimeve të bera në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017.

2.4. Gjithashtu gjatë vitit 2021, nga prokurorët e apelit janë kryer detyrimet ligjore në fushën e **ekzekutimit të vendimeve penale**, ku janë **192** raste të nxjerrjes së urdhërave të ekzekutimit, që lidhen me vendimet me ekzekutim të menjëhershëm të Gjykatës së Apelit Vlorë, për rastet si në vijim:

55 urdhra ekzekutimi ndaj personave që u është ndryshuar masa e sigurimit me e butë e caktuar në shkallën e parë, me masën e sigurimit arresi në burg nga 26 të tilla gjatë vitit 2020.

137 urdhra ekzekutimi ndaj personave që u është ndryshuar masa e sigurimit me një masë më të butë nga arresti në burg, nga 89 të tilla gjatë viti 2020.

Numri i urdhërave të ekzekutimit të prokurorëve të apelit gjatë vitit 2021, është më i lartë se i atyre të nxjerrë gjatë vitit paraardhës.

3. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS PËR ÇËSHTJET E THEMELIT

3.1. Për çështjet e themelit, në total, gjatë vitit 2021 nga prokurorët është përfaqësuar akuza edhe pse me vakanca të theksuara në organikë, në **374** çështje të gjyqimit në themel.

Ka patur 479 persona të pandehur, nga të cilët 271 kanë qenë të arrestuar dhe sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon :

- **Vlorë - 119** çeshtje (prej të cilave **17** çeshtje të dhunës në familje dhe 6 çeshtje me të mitur, 7 kundravajtje), me **154** të pandehur (17 per dhunë në familje dhe 7 të mitur), prej të cilëve **91** persona të arrestuar (10 per dhunë në familje dhe 1 të mitur).
- **Fier - 150** çeshtje (prej të cilave **20** çeshtje të dhunës në familje dhe 10 çeshtje me të mitur), me **194** të pandehur (36 per dhunë në familje, 10 te mitur, 4 kundravajtje), prej të cilëve **105** persona të arrestuar (9 persona të arrestuar per dhunë në familje dhe 5 të mitur)
- **Berat - 53** çeshtje (prej të cilave 11 çeshtje të dhunës në familje dhe 1 të mitur, 3 kundravajtje), me **80** të pandehur (15 per dhunë në familje, 1 mitur, 3 kundravajtje), prej të cilëve **44** persona të arrestuar (6 per dhunë në familje).
- **Lushnjë - 49** çeshtje (prej të cilave 9 çeshtje të dhunës në familje), me **51** të pandehur (10 per dhunë në familje), prej të cilëve **32** persona të arrestuar (4 per dhunë në familje).

3.2. Nga numri total i çështjeve të themelit dhe i masave të sigurimit personal të përfaqësuara në Gjykatën e Apelit Vlorë, për **188 ankime**, apelues kanë qenë **Prokuroritë** e Shkallës së Pare, kurse për **889** ankime, apelues kanë qenë të pandehurit.

Për çështjet e themelit sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon:

76 apele te prokurorit per themelin si me poshtë:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Vlorë - 32** apeline të prokurorëve.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Fier - 25** apeline të prokurorëve (2 për çështje të dhunës në familje).

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Berat - 16** apeline të prokurorëve (1 për çështje të dhunës në familje).

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Lushnjë - 3** apeline të prokurorëve.

3.3. Per çështjet ku apelues ka qenë prokurori, të dhënat paraqiten si vijon:

14 apeline të prokurorëve të shkallës së pare, kanë qenë për **pafajësi** ndaj të pandehurve (Vlora- 7, Berati- 6, Lushnja 1).

1 apeline të prokurorëve të shkallës së pare, kanë qenë për **pushim** të çështjes apo akuzës (**Vlorë -1**).

61 apeline të prokurorëve të shkallës së pare, kanë qenë për **lloj apo masë** dënimi të konsideruar të butë (Vlora - 24, , Fieri - 25, prej të cilave 2 dhunë në familje, Berati -10, prej të cilave 1 dhunë në familje), Lushnja - 2.

Ndër çështjet e apeluara, në **62** raste gjykata e apelit ka vendosur **mospranimin** e apelit, ndër të cilat në **18** raste është hequr dorë nga prokurorët e apelit, në të cilat në të gjitha **44** rastet të tjera është disponuar **nga gjykata** per mosplotësim të shkaqeve formale të apelimit.

Sqarojmë se këto qëndrime janë kryesisht për dënime të buta, për vepra penale me rrezikshmëri të pakët shoqërore, si dhe në rastet e aplikimit të dënimeve alternative nga gjykata.

Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **374** në total, nga të cilat për (57 çështje të dhunës në familje, 14 kundravajtje, 17 te mitur), kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për **lënie në fuqi** të vendimit të shkallës së parë, për të cilat Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur si vijon:

3.5 Në **198** çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin (prej të cilave 34 çështje të dhunës në familje dhe 7 çështje me të mitur),

në **135** raste gjykata ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit**

në **48** çështje e ka ndryshuar vendimin, duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit (prej të cilave 10 çështje të dhunës në familje),

në **7** raste e ka prishur vendimin dhe ka **pushuar** çështjen,

në **8** raste e ka prishur vendimin dhe ka kthyer çështjen për **rigjykim**.

3.6. Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **73** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për ndryshim të vendimit të Shkallës së Parë dhe **rëndim** të pozitës së të pandehurit, për të cilat Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur si vijon:

-Në **30** çështje e ka **lënë në fuqi** vendimin (prej të cilave **2** janë çështje të dhunës në familje,)

-Në **10** çështje e ka ndryshuar vendimin duke **rënduar** pozitën e të pandehurit (prej të cilave 2 janë çështje të dhunës në familje, 1 çështje me të mitur),

-Në **31** çështje e ka ndryshuar vendimin duke **lehtësuar** pozitën e të pandehurit(2 dhune në familje, 2 te mitur)

-**2** çështje ka ndryshuar vendimi dhe rikthim aktesh (1 për te mitur)

3.7. Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **27** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për ndryshim të vendimit të shkallës së parë dhe **lehtësim** të pozitës së të pandehurit, nga të cilat janë **pranuar** kërkesat në **17** raste janë lënë në fuqi ,në **9** raste lehtësuar dhe **1** raste është **pushuar** Gjykata e Apelit Vlorë.

3.8 .Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **3** raste kërkesat e prokurorit të apelit kanë qenë për ndryshim të vendimit të shkallës së parë dhe pushim të gjykimit, nga të cilat 1 raste është lënë në fuqi dhe 2 raste prishje /pushim.

3.9 Në gjykimin e çështjeve të apeluara, në **11** raste kërkesat e **prokurorit të apelit** kanë qenë për prishje të vendimit të shkallës së parë dhe rikthim të çështjes për **rigjykim**, nga të cilat gjykata e apelit ka vendosur si vijon:

në **2** raste është pranuar kërkesa e prokurorit të apelit për kthim të çështjes për **rigjykim**.

në 8 raste është lënë në fuqi dhe në **1** raste prishje /pushim/pafajësi.

3.10. Lidhur me ndarjen e çështjeve të gjykuara në gjykatën e apelit, për **krimet dhe kundravajtjet penale**, të dhënat e vitit 2021 paraqiten si më poshtë :

- për **360** çështje, me **465** të pandehur dhe **271** të arrestuar, apelimet kanë qenë për **krime**.
- për **14** çështje kanë qenë për **kundravajtje penale**.

3.11. Gjatë vitit 2021, prokurorët e apelit kanë ushtruar **rekurs** mbi vendimet për **çështjet e themelit** të gjykatës së apelit në **17** raste, ku sipas rrethëve gjyqësore të dhënat janë si më poshtë

- **10 rekurse** per vendimet e rrethit të **Vlorës** (ku 1 çështje është me të mitur), **4 rekurse** per vendimet e rrethit të **Fierit**, **2 rekurse** per vendimet e rrethit të **Beratit**, **1 rekurs** per vendimet e rrethit të **Lushnjës**.

3.12. Gjatë vitit 2021, prokurorët e apelit kanë ushtruar **rekurs** edhe mbi vendimet per **çështjet e vecanta** të gjykatës së apelit në **6** raste, përfshirë çështje që lidhen me ekzekutimet e vendimeve penale, marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, rivendosjet në afat etj.

4. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNES PER ÇËSHTJET E MASAVE TË SIGURIMIT.

4.1. Në gjykimin e masave të sigurimit, në total gjatë vitit 2021 nga prokurorët është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit Vlorë per **534 persona** (vitin paraardhës ishin 525), ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si në vijim :

275 persona nen hetim (**210 çështje**) per masa sigurimi nga Prokuroria e Rrethit **Vlorë**,

271 persona nen hetim (**217 çështje**) per masa sigurimi nga Prokuroria e Rrethit **Fier**,

66 persona hetim (**54 çështje**) per masa sigurimi nga Prokuroria e Rrethit **Berat**,

64 persona (**53 çështje**) per masa sigurimi nga Prokuroria e Rrethit **Lushnjë**.

4.2. Nga ky numër i çështjeve të përfaqësuar në Gjykatën e Apelit, për **112** prej tyre **apelues** kanë qenë **prokuroritë** e Shkallës së Parë në krahasim me 100 apele te vitit të kaluar, kurse per 513 kanë qenë apelues të pandehurit, ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Vlorë** - **46** apelime të prokurorëve.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Fier** - **54** apelime të prokurorëve.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Berat** - **10** apelime të prokurorëve.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Lushnjë** - **2** apelime të prokurorëve.

4.3. Në **56** raste të **apelimeve** për masat e sigurimit, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur **mospranimin** e tyre, ndër të cilat në **29** raste është hequr dorë nga prokurori i apelit, ku sipas rretheve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon :

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Vlorë** - **20** vendime gjyqësore mospranimi,

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Fier** - **23** vendime gjyqësore mospranimi.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Berat** - **7** vendime gjyqësore mospranimi,

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor **Lushnjë** – **6** vendime gjyqësore mospranimi.

Në lidhje me masat e sigurimit, heqja dorë nga ankimi është bërë për shkak të situatës së pandemisë, situatë e cila ka kushtëzuar zbutjen e qëndrimit të prokurorit për masat e sigurimit.

4.4. Ne **114** raste të apelimeve për masat e sigurimit (Vlore - 49, Fier - 55, Berat - 8, Lushnje - 2), **Prokurori i Apelit** ka kërkuar **ndryshimin** e vendimit si vijon :

Në 77 raste (Vlore - 34, Fier - 36, Berat - 7, Lushnje - 0) prokurori i apelit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit **arrest ne burg**, sipas apelit të prokurorit të Shkallës së Parë,
Në 37 raste (Vlore - 15, Fier - 19, Berat - 1, Lushnje - 2) prokurori i apelit ka kërkuar caktimin e masave të sigurimit me të buta nga vendimi i Shkallës së Parë.

4.5. Për këtë kërkim të prokurorit të apelit, Gjykata e Apelit vlore ka vendosur si vijon :

Në 18 raste (Vlore - 8, Fier - 8, Berat - 2, Lushnje 0) ka caktuar masën e sigurimit **arrest ne burg**, sipas apelit të prokurorit të Shkallës së Parë,

Në 37 raste (Vlore - 14, Fier - 18, Berat - 3, Lushnje - 2) ka caktuar masë sigurimi më të buta nga vendimi i Shkallës së Parë.

Në 59 raste (Vlore - 26, Fier - 30, Berat - 3, Lushnje - 0) ka **lënë në fuqi** vendimin e Shkallës së Parë.

Në 362 raste (Vlore - 110, Fier - 115, Berat - 35, Lushnje - 37), kryesisht për ankime të tetauarve, **prokurori** ka kërkuar **miratim** të vendimit të Shkallës së Parë.

4.7. Për këtë kërkim të prokurorit të apelit, Gjykata e Apelit Vlore ka vendosur si vijon :

Në 297 raste (Vlore - 110, Fier - 115, Berat - 35, Lushnje - 37) ka **miratuar** vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë

Në 65 raste (Vlore - 35, Fier - 19, Berat - 3, Lushnje - 8) ka caktuar masë sigurimi më të buta nga vendimi i Shkallës së Parë.

4.8. Për 23 çështje që lidhen me **masat e sigurimit**, prokurorët e apelit kanë ushtruar të drejtën e **rekursit** në Gjykatën e Lartë, ku sipas rrethëve gjyqësore të dhënat paraqiten si vijon :

11 rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Vlore**, 9 rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Fier**, 2 rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Berat**, 1 rekurse për vendime që lidhen me çështje të rrethit **Lushnjë**.

5. TË DHËNAT MBI NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR

Gjatë vitit 2021 ngarkesa e punës për çdo prokuror ka qënë në nivele më të larta se viti i kaluar, tregues në të cilin ka ndikuar edhe pakësimi i numrit të prokurorëve të kësaj Zyre, për shkak të largimit nga detyra të tre prokurorëve.

Ndërkohë ngarkesa midis prokurorëve në detyrë është në nivele të përafërta, çka është tregues i një organizimi të mirë të brendshëm të punës dhe bashkëpunimi ndërmjet prokurorëve, që përbën përmbushje të detyrimit ligjor për ndarjen e barabartë të punës në prokurori.

Në lidhje me mënyrën e ndarjes së çështjeve, theksojmë se për shkak të situatës së krijuar në vitin 2021, përgjatë të cilit kanë ushtruar funksionin vetëm 2 prokurorë, jemi detyruar të heqim dorë nga procedura e ndjekur deri në fund të vitit 2020, ku çdo prokuror ngarkohej me short për të ushtruar funksionin pranë

Adresa : Rruga "Gjergj Kastrioti", Vlore

Ëëbsite : ccc.pp.gov.al

një kolegji të caktuar gjyqësor, short i cili garantonte edhe rotacionin përmes riformatimit për çdo vit të trupave gjyqësore nga Gjykata e Apelit. Kjo mënyrë të proceduari në fakt kishte rezultuar efikase deri në atë periudhë, pasi nuk shkaktonte mbivendosje të orareve dhe zvarritje të gjykimeve, por situata e krijuar nga fillimi i vitit, e bëri tërësisht të pamundur këtë mënyrë ndarje të çështjeve.

Për këtë arsye, ndarja e çështjeve bëhet sipas shortit të thjeshtë manual, për të cilin rezulton qartësisht se ka transparencë dhe kjo duket qartë nga të dhënat statistikore, ku vetë drejtuesi rezulton me të dhëna të krahasueshme me prokurorin tjetër në detyrë.

Të dhënat mbi ngarkesën e punës për çdo prokuror, ku përfshihet edhe përfundimi i çështjeve të mbartura nga vitit 2021, në përfaqësimin e çështjeve të ndryshme në Gjykatën e Apelit Vlorë për vitin 2021, paraqiten si në vijim.

5.1. Prokurori **Pelivan Malaj**, është shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në Janar të vitit 2021 dhe nuk ka përfaqësuar Prokurorinë e Apelit në asnjë çështje penale.

Prokurori **Enrik Haxhiraj** është shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit po në Janar të vitit 2021, dhe rezulton se ka përfaqësuar Prokurorinë e Apelit në 4 çështje penale, me objekt ankim ndaj masave të sigurimit.

5.2. Prokurori **Erjon Cela**, i cili për periudhën Shkurt-Shtator ka qene fillimisht i komanduar, e me pas i emruar në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Vlorë, i shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në muajin Shtator të vitit 2021, gjatë periudhës që ka ushtruar këtë funksion ka marrë pjesë në:

- 86 përfaqësime të akuzës për çështje **themeli** (kanë mbetur pa përfunduar 5 përfaqësime, duke u mbartur tek Prokurore Elida Hoxhaj) dhe ka ushtruar **rekurs** për **1** prej tyre,
- **199** përfaqësime për çështje të **veçanta** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 11 çështje tek Prokurore Elida Hoxhaj).
- **161** përfaqësime për **masat e sigurimit** dhe ka nxjerrë **36 urdhëra ekzekutimi** për vendimet gjyqësore.

5.3. Prokurori **Kleanth Zeka**, i cili, deri në muajin Shtator 2021 ka kryer detyrën e prokurorit pranë kësaj Zyre, dhe prej datës 23.09.2021 është i komanduar perkohësisht nga Keshilli i Lartë të Prokurorisë në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Vlorë, gjatë vitit 2021 ka patur këtë vullm pune:

- **223** përfaqësime të akuzës për çështje **themeli** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 29 çështje për vitin 2022) dhe ka ushtruar **rekurs** për **15** prej tyre.
- **282** përfaqësime për çështje të **veçanta** (kanë mbetur pa përfunduar duke u mbartur 6 çështje për vitin 2022) dhe ka ushtruar **rekurs** për **6** prej tyre.
- **290** përfaqësime për **masat e sigurimit**, ka ushtruar **rekurs** për **23** prej tyre dhe ka nxjerrë **126 urdhëra ekzekutimi** për vendimet gjyqësore.

5.4. Prokurore **Elida Hoxhaj**, e komanduar nga Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier ne funksionin e prokurores prane Prokurorise se Apelit Vlore me vendim te Keshillit te Larte te Prokurorise date 23.09.2021, per periudhen Shtator-Dhjetor ka marrë pjesë në:

- o **51** përfaqësime të akuzës për çështje **themeli** dhe ka ushtruar **rekurs për 2** prej tyre.
- o **55** përfaqësime për çështje të **veçanta** , ka ushtruar **rekurs në 1** prej tyre.
- o **80** përfaqësime për **masat e sigurimit** dhe ka nxjerrë **30 urdhra ekzekutimi** per vendimet gjyqësore.

Vlen të theksohet se, me ndryshimet e bëra në Kodin e Procedures Penale me ligjin Nr.41/2021, me te cilin eshte përcaktuar se afati kohor për të ushtruar **rekurs** ndaj vendimeve të Gjykatës së Apelit, fillon nga e dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar, per një numër te caktuar çështjesh të përfunduara në vitin 2021, për të cilat ne kemi parashikuar për të ushtruar të drejtën e rekursit, nuk eshte proceduar ende nga ana jonë pasi mbetemi në pritje të marrjes së vendimeve të arsyetuara.

Nga sa u pasqyrua me siper del e qarte se te dhenat statistikore ne teresi, por edhe ato per cdo prokuror ne veçanti, tregojne qarte per nje volum teper te madh pune te perballuar nga ana jone, i cili ben te domosdoshem plotesimin e vakancave qofte edhe me vetem nje prokuror tjeter, ndonese jemi plotesisht koshiente per situaten teper e rende qe po kalon i gjithe sistemi i drejtesise ne keto momente, si pasoje e zbatimit te ligjit te Vetting-ut.

6. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË.

Gjatë vitit 2021 edhe personeli administrativ i kësaj zyre, ndonëse i kufizuar numerikisht, e ka kryer me korrektësi detyrën e vet, duke qenë mbështetje për prokurorët në përballimin e kësaj ngarkese në punë.

Gjatë vitit 2021, buxheti financiar i kësaj zyre është administruar me korrektësi dhe rigorozitet.

Si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjete nga Prokuroria e Përgjithshme, nga ana e kësaj prokurorie buxheti është realizuar thuajse 100% dhe janë likuiduar të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë dhe personelit.

Po ashtu janë mbajtur të gjithë regjistrat financiarë, sipas detyrimeve ligjore dhe udhëzimeve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Financave, ndërkohë që funksionimi i cams-it ende nuk është implementuar pranë kësaj zyre.

Gjatë vitit 2021 respektimi i disiplinës në punë dhe etikës është mbikqyrur nga drejtuesi i kësaj zyre dhe nuk janë hasur problematika në këtë drejtim.

7. OBJEKTIVAT PER VITIN 2021.

Nga analiza në tërësi e treguesve që u përmendën më sipër, për vitin 2021 prioritetet kryesore të Prokurorisë së Apelit Vlorë do të jenë si në vijim:

- Zbatimi me prioritet i Udhëzimit nr 4, datë 09.07.2021 "*Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*", Urdhërit nr.79, datë 09.07.2021 "*Për miratimin e planveprimt për zbatimin e e*

rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit” si dhe Urdhërit nr. 78, datë 09.07.2021 “Për miratimin e planveprimit për zbatimin e rezolutës”.

- Përfundimi sa më parë i të gjitha çështjeve penale të mbartura në gjykim në vitin 2022, për të cilat duhet theksuar se një pjesë e mirë e tyre kanë përfunduar deri në përfundim të muajit Shkurt/2022, vazhdimi i ndjekjes me përparësi të përfaqësimit të akuzës në çështjet e ankimuara që janë në fokus të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe planit të veprimit në zbatim të saj, rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sidomos ato që lidhen me krimet kundër jetës të kryera me dashje, ato në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, kundër rendit e sigurisë publike dhe trafiqeve të të gjitha llojeve, veprat penale kundër drejtësisë, ato që çenojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve etj.
- Rritjen e nivelit cilësor të përfaqësimit të akuzës në apel.
- Rritjen e nivelit cilësor të rekurseve në Gjykatën e Lartë.
- Konsolidimi i mëtejshëm i bashkëpunimit shumë të mirë me prokuroritë e rretheve gjyqësore, me strukturat e policisë së shtetit dhe me Prokurorinë e Përgjithshme, pikërisht në funksion të rritjes së cilësisë së përfaqësimit të akuzës në apel.
- Respektimi nga prokurorët i detyrimeve të ligjit procedural penal, ligjit organik të Prokurorisë dhe urdhrave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Ruajtjen e figures së pastër të prokurorëve dhe respektimin prej tyre të normave të solemnitetit në gjykim, etikës dhe të sjelljes së denjë në publik.

DREJTUESI I PROKURORISË

KLEANTH ZECA

